



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 34

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRISË SË
EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, PËR PERIUdhËN 17 JANAR – 18
JANAR 2025**

Sot, më datë 24.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 17 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17-18 janar 2025, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

Data: 24.1.2025 Nr: 34
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 17 janar – 18 janar 2025”

- Ekonomi, “Intervistë në emisionin E-ZONE, Vizion Plus, për projektligjin e Paketës së Maleve i parashikuar në buxhetin e 2024”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 19.1.2025,
- Kulturë, “Zv. Ministria e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës, dhe Inovacionit, znj. Lira Pipa, live në Artkand, Top Channel për projektin e fondacionit francez ArtExplora x Vila 31”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 18.1.2025,

Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Në lidhje me veprimtaritë të gjykuara nga ana juaj si të ndaluara për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për periudhën 11 janar - 18 janar 2025, ju lutem gjeni si më poshtë dy dokumenta që vërtetojnë aktivitetet e raportuara me vonesë nga ana jonë për sa më poshtë: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- Ekonomi, “Intervistë në emisionin E-ZONE, Vizion Plus, për projektligjin e Paketës së Maleve i parashikuar në buxhetin e 2024”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 19.1.2025.

- Kulturë, “Zv Ministria e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës, dhe Inovacionit, znj. Lira Pipa, live në Artkand, Top Channel për projektin e fondacionit francez ArtExplora x Vila 31”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 18.1.2025

Të dy eventet janë lehtësisht të justifikueshëm me dy dokumenta që vërtetojnë nëpërmjet një shkrese me firmë nga Drejtuesit e Emisioneve, ftesat e të cilave i kanë bërë jashtë afatit 5 ditor”.

Referuar pikës 3 , të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, parashikohet se raportimi në NRI për një veprimtari publike duhet të bëhet jo më vonë se 5 (ditë) përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet nga për veprimtari të cilat organizohen ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues.

Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se personi përgjegjës për raportimin i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se ka qenë në cilësinë e të ftuarit dhe nuk ka detyrim për raportim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI